



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E TRETË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.04.2026 (e mërkurë)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Basri Aliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, zn.Liridona Bislimi, znj.Elsa Jahija. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se janë prezent të gjithë anëtarët e KPF-së dhe ka kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të rregullt të KPF-së. Pra, materialin e keni marrë me kohë, para se të hymë në debat kisha kërku prej drejtorive që kanë pika, të vijnë më herët, për shkak se na duhen 7 ditë para mbledhjes ta kompletojmë materialin. Para se me hy në rend të ditës, hapim diskutim.

zn.Liridona Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sa i përket kërkesës ose qasjes paraprake, natyrisht që edhe ne i përshtatemi kësaj thirrjeje, për shkak se, siç e patëm edhe pikën e fundit në rendin e ditës, kemi pasur komplet materialin, por vetëm me një fletë; nuk ka pasur material të hollësishëm, nuk kemi pasur informacion se çka me diskutu. Materiali na ka ardhur aty për aty, te pika e fundit për parcelën, dhe nga ana jonë kërkesa është e njëjtë, sepse mandej edhe ne po arrijmë në përfundim se qytetarët po interesohen për pikat e rendit të ditës dhe normalisht që ti del shumë keq si përfaqësues kur thua se nuk ke informacion më të hollësishëm. Këtë javë ka marrë një vendim Komuna e Mitrovicës për me ia bërë kompensimin për punën dhe angazhimin e kryetarëve të këshillave të fshatrave. Mendoj që është mirë si komunë me iu referu mënyrës dhe qasjes, domethënë e kemi si shembull më të freskët që e kanë bërë, dhe me u bazu në atë mënyrë se si ata e kanë përgatitur, si dhe mënyrën se si e kanë bërë, cilit ligj i janë referuar dhe sa është pagesa.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Gjatë katër viteve që kemi pasur takime, edhe me asociacionin, pushtetin lokal dhe me Ministrinë e Financave, gjithmonë ka qenë temë pagesa për këshillat e fshatrave, për KKSB-në dhe komitetet jo obligative. Asnjëherë nuk kanë mundur me na dhënë një përgjigje, sepse Ligji i Pagave çdo qasje të pagesave tjera i ka ndaluar. Për këtë arsye ka pasur problematikë, sepse vendimin e parë e kishim zgjedhur dhe i kishim formuar komitetet jo obligative në kuvend, por derisa nuk mundemi me i zbatu aty, edhe kjo pjesa tjetër ka me qenë në vështirësi. Këtë vendim e ka bërë më herët edhe Suhareka, por nuk ka mundur me pagu asnjë.

z.Illir Zuka: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam pasur dëshirë që në këtë mbledhje të jetë prezent drejtori i Shërbimeve Publike dhe drejtori i Inspeksionit. Ne e dimë që tash e një muaj ka qenë muaji i pastrimit. Unë nuk e di në qoftë se kjo bëhet për reklamë, për votë apo për gjëra tjera për disa individë të caktuar, kjo nuk sjell votë. Ne e kemi provuar edhe në Pozheran. Në Pozheran kemi pasur një deponi për dy vite; katër herë ish-drejtori i Shërbimeve Publike, Basria, ka intervenuar dhe e ka hequr. Hajde shikojeni çka është aty sot. Problemi

është te inspekcioni dhe te higjiena, sepse në Pozheran vetëm rreth 70% e shtëpive janë në sistem. Këto 30% ku i hedhin mbeturinat? Unë nuk kam nevojë me heqë bërlllogun kur pagesa është vetëm 6 euro e 70 cent në muaj, domethënë rreth 73 euro në vit, vjen dhe ta merr te dera. Nuk është zgjidhje kur dikush është në sistem e tjetri jo. Sa të duam ne me dalë e me pastru, kur ka shtëpi që nuk janë në sistem, duhet të angazhohet inspekcioni dhe higjiena. Kush nuk është në sistem, ku po i hedh mbeturinat? Të jesh i bindur, rruga Pozheran - Viti, konkretisht rruga “Sabit Zuka”, është bërë e pakalueshme. Po i bëj kërkesë zyrtarisht drejtorit Ilir; ai thotë “dalim e i heqim bashkë”. Drejtor, unë nuk dal me heqë bërlllog, unë jam i zgjedhur si qytetar i Pozheranit, si përfaqësues, për me i ngrit ankesat e tyre. Prap po e them: banorët e fshatit Pozheran duhet 100% me qenë në sistem për hedhjen e mbeturinave. Dhe tjetra, ne kemi kërkuar prapë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike me intervenu, sepse ka kaluar mbi 6 muaj që ndriçimi publik në Pozheran nuk bënë, dhe në shumë vende ku ka pasur drita, ato kanë dhënë tym gjatë gjithë kohës dhe nuk kemi ditur si me i ndalë. Po ashtu, në oborrin e QMF-së në Pozheran, qentë endacakë kanë sulmuar një qytetar, dhe kjo është jashtëzakonisht shqetësuese. Për këto çështje besoj që duhet me u gjet një zgjidhje, sepse është në të mirë të qytetarëve.

z.Basri Aliu: Po lidhem pak me çështjen që e ngriti Iliri për mbeturinat. Për mbeturinat fajin e kemi të gjithë që nuk po bëjmë zgjidhje, sepse nuk është as kompania “Ekohigjiena” e thirrur me i mbledhë bërllloqet nëpër vende ku nuk janë deponi, por as drejtoria tjetër nuk është ajo që duhet me u marrë plotësisht me këtë çështje. Në fund i bie barrë Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Megjithatë, duhet me gjetë një zgjidhje për me mujtë me i shti në sistem familjet që nuk janë të përfshira. Metoda, për shkak të ligjeve, është pak telash, sepse sipas ligjit ata vetë duhet me shku me bë kontratë me kompaninë. Këtu është problemi: ata nuk shkojnë. Por një kontroll më i madh nga inspekcioni mundet me i shty, sepse në momentin që i gjejnë duke hedhë mbeturina, së paku me i detyru me shku me u regjistru te kompania që merret me mbledhjen e mbeturinave. Po ashtu, edhe ndikimi ynë ka rëndësi. Ne duhet me u marrë me ata banorë, me komshinjtë tanë, me ju thënë: ku jeni tu i hudhë mbeturinat? Unë kam edhe një shqetësim tjetër. Kam diskutuar me drejtorin e inspekcionit, por ende nuk kemi arritur një marrëveshje. Duhet me marrë një aksion për largimin e azbestit (selominit), sepse ai është i rrezikshëm dhe kancerogjen. Ende ka nëpër qytet objekte ku është i vendosur dhe kjo paraqet rrezik serioz për shëndetin. Për këtë çështje duhet me u marrë inspekcioni. Ata arsyetohen se nuk janë prona tona, por pa marrë parasysh a janë prona tona apo private, inspekcioni është aty ku ka rrezik, dhe duhet me vepru si në prona private ashtu edhe në ato shoqërore. Duhet me u ndërmarrë një veprim konkret në këtë drejtim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përhëndetje për të gjithë të pranishmit. Drejtori i Shërbimeve Publike më ka obliguar që për pikën e rendit të ditës të jem unë, për shkak të angazhimeve që i ka; është në mungesë me leje, për shkak se është Dita e Tokës. Po e shoh, Liridon, vullnetin tënd dhe të kryetarit atje, por nganjëherë vullneti, kur nuk është në përputhje me ligjin, has në pengesa. Nuk jam ithtar i marrjes së iniciativave populiste për me përfitu, qoftë në aspekt personal apo politik të votave, por në fund, siç tha edhe kryesuesi, ligji na thotë ndryshe. Është një karakteristikë në Kosovë: thuhet se pushtetet janë dy, pushteti lokal dhe pushteti qendror, dhe nuk njihet pushteti i tretë. Në anën tjetër, në shumë vende përmenden këshillat e fshatrave, por kur bëhet ndarja e pushteteve, ato nuk trajtohen si pushtet më vete, por organizimi ndahet në këto dy nivele. Unë kam thënë që vetë pagesa, në momentin që bëhet, duhet me i dhënë edhe përgjegjësi dikujt. Tash jemi në këtë çështje: këto punë kryhen në aspekt vullnetar, kur duan i kryejnë, kur nuk duan jo; të them të drejtën, shumica nuk i kryen. Unë kam qenë prezent në vendin e ngjarjes kur, të dielën, para syve të mi, duke e ditur që jam nënkryetar komune, dikush po i hidhte mbeturinat. Nuk kemi çka diskutojmë për nivelin tonë. Këtë popullatë, për me e shti në sistem, duhet me pru një vendim ligjor për kushtëzim. A do të bëjmë diçka në themelimin e kësaj kompanie? A duhet, para kësaj, të ulet zyra ligjore së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike për me i futur në sistem, dhe gradualisht në atë vendim me i caktu kriteret, cilat kategori po i lirojmë, për shembull ata që janë me asistencë sociale? Ndoshta kjo është e vetmja rrugë për me arritë deri te një zgjidhje.

Sa i përket qenve endacakë, e kemi dërguar përpara procedurën për me dalë në tender dhe me fillu eliminimin e tyre. Megjithatë, nuk mund të eliminohen krejt, sepse ata riprodhohen përsëri; ky është problem në nivel të Republikës së Kosovës. Basri, çështja që e ngrite është shqetësuese për qytetarët. Ndoshta ne nuk mundemi me marrë iniciativë të menjëhershme, por edhe këtu duhet me ardh një vendim: me e propozu kryetari i komunës dhe me e aprovu kuvendi, që me pas bazë ligjore. Duhet me pas edhe mendimin e ekspertëve nga niveli qendror, që vërtet këto materiale janë kancerogjene dhe të dëmshme për popullatën. Pastaj, duke u thirrë në atë vendim, me ia dërgu Drejtorisë së Inspektionit, e cila duhet me dhënë afat, edhe për sektorin privat, përshembull brenda një muaji me e eliminu këtë rrezik, sepse nuk ka formë tjetër.

z.Basri Aliu: Për tek format private, edhe unë jam i pajtimit me shku në këtë formë, por disa prona shoqërore që kemi, mundemi vetë ato me i hjek.

z.Jakup Demiri: Këto materialet e azbestit, të cilat ekspozohen ndaj stinëve, dimrit dhe verës, apo ambienteve të hapura, janë me rrezikshmëri të lartë dhe konsiderohen shkencërisht si kancerogjene. Do të ishte mirë që ne me punu në këtë drejtim dhe me ndërmarrë hapa konkretë në komunën tonë. Unë kam marrë pjesë edhe në një punëtori në Kolegjin AAB për çështjen e azbestit, dhe profesori e paraqiste në mënyrë shkencore se sa i rrezikshëm është. Ata kishin një mënyrë të veçantë të mirëmbajtjes, sepse nuk është i dëmshëm vetëm për njerëzit dhe kafshët, por edhe për pjesën bimore, pra, është i rrezikshëm për gjithë mjedisin.

zn.Liridona Bislimi: Te kompensimi i kryetarëve të këshillave të fshatrave, ne këtu po dalim me një konkludim që kemi pasur raste të komunave më herët që kanë bërë pagesa. Tash kemi edhe një rast të ri që ka dalë, ku është bërë një miratim — ka ardhur si pikë e rendit të ditës në komitet dhe ka shkuar për në kuvend komunal. Tani është mirë me e marrë parasysh dhe me e analizu nëse kjo kalon si pikë në kuvend komunal dhe fillon me u bë lëshimi i mjeteve; është mirë me e marrë si shembull. Ne, më së pari, këtë temë që e kemi përmendur, nuk i kemi as përfaqësuesit e rinj — domethënë këtyre aktualëve u ka skaduar mandati që një kohë bukur të gjatë dhe nuk kemi proceduar absolutisht asgjë. Edhe nëse ndodh kjo që po e propozoj unë, këtyre nuk ua lejon ligji, për shkak se mandatin e kanë të skaduar. Prandaj, mirë do të ishte me fillu me procedurë të re, me zgjedhjen e përfaqësuesve të rinj, dhe pastaj kjo çështje me u përcjellë më tutje. Kjo ka me shku si pikë në MAPL; ata zakonisht e kthejnë përgjigjen dhe nuk e vonojnë shumë. Dhe nëse ndodh që e kthejnë përgjigjen pozitive, pse mos me e marrë edhe ne si shembull atë praktikë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Një ditë kemi pasë takim me kryetarin dhe me egzekutivin dhe një prej shqeytimeve kemi shqeyrtu dhe qeshtjen e madnateve të kshillave të fshatrave ti e di që komisioni duhet me ardh nga kuvendi së bashku me egzekutivin me formu komisinin dhe me fillu në zbatueshmëri të rregullores për mbajtjen e mbledhjeve për zgjedhjen e kshillave të fshatit ajo që ka kalu vitin e kalum nuk ka pas lezet në vitin e zgjedhjeve shumë është problematizimi i këtyre qeshtjeve përshkak. Se krijon plasartije edhe politike edhe pse ne rregullore thot se kryetaret e keshillave të fshatrave duhen të jenë a politik po ne Kosove apolitik nuk ka mbete askush prandaj për këtë qeshtje e kemi shty edhe tash besoj se shpej do ta kemi propozimi vendimi me e formu komisionin dhe me fillu me I zgjedhje unë jam idhetar e gjetjes se pageses e tani e keshyrmi e do të marrim të gjitha shembujt e mirë a jan tu bë punë të mira kryetaret e fshatrave jo hiq vetëm kur të kane qeshtje personale të vetat qeshtja e berllotit ne ren të par është e keshillave të fshatrave hajde ta deshmim një kryetar i keshillit të fshatit që I ka mbajt dhjet mbledhje dhe temë e ka pas jekje e berllotit ne fshat as një nuk e ka pas.

z.Illir Zuka: Unë realisht nuk kam të drejtë me fol si administrator, sepse i përkas një subjekti politik, por pasi që më kanë zgjedhur qytetarët, duhet me fol dhe me e kundërshtu nënkryetarin, sepse ne, brenda vitit, i mbajmë rreth 10 mbledhje si këshill i fshatit dhe kemi bërë shumë punë të mira. Duke filluar prej ndërtimit të shtëpive, shtatores në Koshare, kemi hequr deponi të berllotit duke bashkëpunuar me drejtorin e Shërbimeve Publike. Për disa vite kemi hequr shumë deponi në Pozheran, mbi 10 deponi, gjithmonë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Unë kam pasur rast që e kam lajmëruar një qytetar që kishte hedhur mbeturina, por ai në mbrëmje më ka ardhur të shtëpia, sepse Policia e kishte njoftuar që unë e kam lajmëruar.

z.Basri Aliu: Isha tash në vizitë në Angli dhe i pashë si i menaxhojnë mbeturinat atje. U deshke me prit një

javë ditë që kompania me ardhë me i marrë; të gjitha i kishin lënë në thasë para dyerve. Mirëpo atje nuk kishte që dikush me i shpërnda. Kur i ka ardhur radha kompanisë me i marrë, i ka marrë të gjitha.

z.Jakup Demiri: Çdo vend i ka rregullat e veta. Unë në Gjermani, ku i kam vëllezërit, isha para dy viteve; atje ka kushtuar me pagesë me i heq mbeturinat, por sistemi është i rregullt. Këtu te ne, zyrtarët e komunës deri në ora 10 nuk shkojnë në zyrë. Më mirë është me dalë në terren, me pa ambientin dhe me bë gjoba, sesa me nejt në kafe. Si komunë jemi shumë keq sa i përket respektimit të orarit të punës. Edhe inspektorati, sa rrin në kafe, më mirë është me dalë në terren, me bë vizita në natyrë dhe në fshatra. Jo në këtë kohë kur gjithçka është mbuluar me bar. Duhet me dalë më shumë në terren inspektorët.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë mendoj që i vetmi element që i ndalon është gjobitja. Por tjetra është që ne, bashkë me “Ekohigjienën”, e kemi çështjen e mbeturinave të amvisërisë familjare që janë të rregulluara. Megjithatë, ka edhe disa mbeturina që qytetarët i hedhin dhe më pyesin ku me i hudhë, sepse janë disa lloje mbeturinash që nuk kanë vend të caktuar për deponim. Ne duhet me i caktu disa deponi për këto lloje të mbeturinave. Faleminderit për debatin, materialin e keni marrë me kohë. Vazhdojmë me rendin e ditës. Për këtë seancë kemi paraparë këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2026.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nisjen e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale (NPL) në Komunën e Vitisë.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e parcelës kadastrale të pronës komunale.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: kemi dhe 2 propozime të tjera, janë çështje financiare që duhet patjetër të kalojnë në komitet.

zn.Milihate Ajeti, drejtoresha: Njëra pikë është për Demosin. Kemi kaluar edhe një herë në kuvend, por në momentin që i kemi destinuar mjetet aty, përmes kuvendit, kemi pasur të njëjtin problem — përmbaruesi na i ka marrë mjetet. Prapë kemi mbetur në obligim ndaj Demosit dhe tani kemi obligim me ua kthyer mjetet; do t’ua kthejmë drejtpërdrejt, nëse kalon kjo në kuvend. Janë 105 mijë euro borgj. Dhe tjetra është që dy projektet nuk janë me prioritet. Ne po duam me i dhënë prioritet tribunave të Pozheranit; aty nuk ka mjete të mjaftueshme dhe projekti është më i shtrirë sesa mjetet që i kemi ndarë. Prandaj, këto dy projekte, meqë nuk janë prioritare, me i bashku dhe me e çu përpara projektin e tribunave të Pozheranit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Një sqarim te Demosi: borgji ndaj Demosit është i vitit 2024. Ata nuk kanë mundur me i shpenzuar 105 mijë euro dhe ne kemi qenë të obliguar me i kthyer në vitin 2025. Nuk kemi mundur, për shkak se mjetet i ka marrë përmbaruesi. Këtë vit ata kanë kontaktuar tash e një muaj me mua; më janë lutur shumë që mos me i detyru me na dërgu te përmbaruesi, por edhe unë nuk jam i interesuar me shku te përmbaruesi privat, për shkak se si organizata kemi pasur bashkëpunim të mirë. Prandaj, duhet me e çu këtë çështje në komitet e pastaj në kuvend. Ata kanë kërkuar që, pas vendimit të komitetit sot, në rast se shkon në kuvend, me ua dërgu një propozim-vendim. Këtë e kanë kërkuar edhe Fatlumi, si dhe procesverbalin që komiteti është pajtuar me e dërgu në kuvend për me e miratu këtë vendim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Sa i përket Demosit, edhe në mandatin e kaluar kemi pasur takime dhe ata kanë kërkuar nga ne, nga kuvendi, për këtë çështje.

z.Jakup Demiri: Tek këto tribunat e stadiumit të Pozheranit, kjo ende nuk i ka kry fazen e prokurimit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Në kodin e ndërtimit të stadiumit të Pozheranit kanë qenë vetëm 30 mijë euro. Në takimin që kemi pasur me zyrën e prokurimit, është thënë që nuk mund të shpallet tender me 30

mijë euro, kur vlera e projektit është rreth 230 mijë euro. Prandaj është kërkuar që të merren mjete nga projekte të tjera, përmes ridestinitimit, nga ato që nuk janë me prioritet.

z.Jakup Demiri: Shumë i qartë je, sepse janë dy pika. Njëra lidhet me këtë: kur kam diskutuar unë, kam folur për palestrën sportive shkollore të Smirës dhe aty figurojnë vetëm 10 mijë euro. Kjo ndodh kur futen shumë projekte dhe në fund nuk bëhet asnjë.

z.Illir zuka: Sot për sot, në Pozheran, një ndër më të nevojshmet është tribuna e stadiumit. Para disa javësh kemi zhvilluar një ndeshje me Iberlepecin; kanë qenë mbi 4 mijë veta në stadium. Mendoj që kjo është një punë e mirë që është duke u bërë dhe uroj që të kryhet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pra, e qes në votim rendin e ditës që të hyjnë edhe këto dy pika të propozuara. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet rendi i ditës me këto dy pika shtesë.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nga të gjithë të pranishmit u miratu procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2026.

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përhëndetje për të gjithë të pranishmit. Po ju prezantojmë në pika të shkurta pasqyrat financiare për periudhën janar–mars 2026.

Buxheti i alokuar për periudhën janar–mars 2026 për të gjitha kategoritë ekonomike është 7,099,162.97 €, ndërsa shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike janë 6,598,950.00 €.

Shpenzimet për kategorinë paga dhe shtesa janë 99.91% në krahasim me alokimet.

Shpenzimet për kategorinë mallra dhe shërbime janë 87.00%.

Shpenzimet për shërbime komunale janë 85.72%.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere janë 92.38%.

Shpenzimet për investime kapitale janë 85.13%.

Në pasqyrat financiare keni të prezantuara buxhetin e aprovuar, të alokuar dhe të shpenzuar për të gjitha programet buxhetore.

Zyra e Kryetarit ka shpenzuar në total 95.17%.

Administrata dhe personeli 91.65%.

Inspeksioni 96.28%.

Zyra e Kuvendit Komunal 98.19%.

Buxheti dhe Financat 84.98%.

Shërbimet Publike 95.39%.

Zyra e Komuniteteve 90.29%.

Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural 95.08%.

Gjeodezia, kadastri dhe prona 95.61%.

Planifikimi urban dhe mjedisi 96.33%.

Shëndetësia 96.92%.

Shërbimet sociale 93.23%.

Kultura, rinia dhe sporti 92.53%.

Arsimi dhe shkenca 97.86%.

Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar–mars 2026:

Të hyrat e planifikuara për vitin 2026 janë 1,294,660.00 €, ndërsa të hyrat e realizuara për periudhën janar–mars 2026 janë 184,510.38 €.

Krahasimi i të hyrave vetanake për periudhën janar–mars 2026 me të njëjtën periudhë të vitit 2025:

Të hyrat në janar–mars 2026 janë 184,510.38 €, ndërsa në janar–mars 2025 kanë qenë 211,217.39 €. Pra, të hyrat e vitit 2026 janë më të ulëta për 26,707.01 €.

Prezantimi i investimeve kapitale për periudhën janar–mars 2026: gjatë kësaj periudhe, shpenzimet nga investimet kapitale në total janë 2,049,077.18 €, të cilat i keni të paraqitura në mënyrë të detajuar në raport.

Vlen të theksohet se nga kjo shumë totale, 1,143,143.30 € janë të ekzekutuara nga Komuna e Vitisë për projektet që kanë punë të kryera, ndërsa shuma prej 905,933.88 € janë shpenzime të ekzekutuara nga Thesari i Shtetit, të cilat janë obligime të viteve të mëhershme që rrjedhin nga Kontrata Kolektive.

Krahasimi i shpenzimeve për periudhën janar–mars 2026 me të njëjtën periudhë të vitit 2025 tregon se shpenzimet e vitit 2026 janë më të larta për 456,226.36 €.

zn.Liridona Bislimi: Drejtoreshë, do të bëj një diskutim të shkurtër vetëm për disa pika, ku jam munduar me bë një krahasim të tremujorit të këtij viti me vitin paraprak dhe disa rritje përqindore që i kam hasur. Kemi rritje shumë të ndjeshme që nuk lidhen aspak me mirëqenien e qytetarëve. Për shembull, te drekat zyrtare kemi 27% rritje, duke folur për të njëjtën periudhë. Te informimi publik kemi rreth 18% rritje. Ajo që është më shqetësuese dhe kërkon analizë më të thellë është fakti që rreth 30 mijë euro është diferenca e rritjes për mirëmbajtjen e objekteve, ndërsa mbi 26 mijë euro për mirëmbajtjen e rrugëve — gjithmonë në krahasim me periudhën e njëjtë. Po ashtu, kemi rritje të konsiderueshme për automjete, për rregullim dhe mirëmbajtje të tyre. Nëse bëjmë një krahasim, nuk ka diçka që proporcionalisht reflektohet në terren. Pra, si përfundim, del që buxheti po orientohet më shumë drejt shpenzimeve operative administrative, e jo drejt investimeve që përmirësojnë jetën e qytetarëve. Këtu problemi janë prioritetet. Kur rriten shpenzimet për dreka dhe për automjete, normalisht që nuk ka rezultat të dukshëm në terren. Te mirëmbajtja e objekteve, a do të thotë kjo që kemi rritje të objekteve për mirëmbajtje? Te mirëmbajtja e rrugëve, territori i Komunës së Vitisë është i njëjtë — si është e mundur që vetëm për tremujorin e parë të kemi një diferencë prej 26 mijë eurosh? Zakonisht, pyetjet që na vijnë nga qytetarët janë: ku po shkojnë mjetet e tyre? Dhe normalisht, kur shihet që po rriten shpenzimet për administratë, ndërsa nuk ka përmirësim direkt që prek jetën e qytetarëve, atëherë del që ky buxhet nuk është në shërbim të tyre, por më shumë i ekzekutivit apo shpenzimeve të tjera. Ka edhe kode të tjera ku kam vërejtur rritje të dukshme, por po e lë diskutimin për seancën e kuvendit.

z.Jakup Demiri: Unë i kam vetëm dy kode, sepse këto janë që një kohë dhe nuk dihet kur përfundojnë. Kodi 13440 – shërbime këshilldhënëse dhe profesionale: në këtë tremujor kemi pagesa në vlerë prej 188 mijë e 592 euro, ndërsa, kodi 13445, shërbime të veçanta, konsulentë dhe kontraktorë individualë: në këtë tremujor janë 3,204 euro. Te kjo shuma prej 188 mijë eurosh është shumë e lartë. Ne e dimë që paguhen 3 persona për me dhënë këshilla profesionale dhe e dimë që asnjëherë nuk janë profesionistë të fushës.

zn.Milohate Ajeti, drejtoresha: Te drekat zyrtare, ne duhet patjetër me i prezantu në momentin kur janë shpenzuar, sepse këto të gjitha janë obligime dhe do të kemi problem deri në fund të vitit, sipas mendimit tim. Problemi është që këto janë kryesisht obligime të vitit 2025. Tash i kemi shpenzuar në fakt dhe patjetër duhet me i prezantu në pasqyrat financiare sa janë shpenzuar, sepse nuk është që shuma është rritur, realisht është në nivel të njëjtë si vitet e tjera, pra është prap e njëjta. Jakup, edhe kjo është obligim i vitit të kaluar. Tash, ajo që ka qenë një pjesë për këtë vit dhe pjesa tjetër janë bashkuar dhe është dashtë me u pagu si borxhe. Për këtë arsye është bërë shuma më e madhe e mjeteve, por kur përfundon nuk e di saktësisht.

z.Illir Zuka: Çka është tu ndodh me pagesat e tatimit në pronë? Para dy viteve kemi falë një vit, ndërsa tash për të tretin vit me radhë më kanë ardh obligime vetëm 10 euro borxh. Çka është tu ndodh?

z.Jakup Demiri: Është keqregjistrim dhe është gjetje e auditorit, por ka mundësi që ky kompensim i tashëm të bëhet në vitet pasuese.

z.Basri Aliu: Lidhur me pasqyrat financiare, drejtoreshë, e di që kjo gjendje nuk është reale për këto çështje të tremujorit, sepse këto shpenzime janë bërë në vitin 2025 për shkak të kontratës kolektive, pasi i kanë marrë mjetet. Pra, nuk është ajo që po duan të bëjnë krahasimin mes këtij tremujori dhe tremujorit të vitit të kaluar. Desha me bë një pyetje: a janë kryer shpenzimet e vitit të kaluar dhe sa kanë mbetur pa u kryer? Këtu, si sqarim, kur është thënë te rritja e objekteve, është e mundshme, sepse këtu është rritur edhe paga e punëtorëve. Ka qenë një pagë më e vogël dhe, kur e kemi çuar këtë kontratë të re, e kemi çuar me rritje të pagës, prandaj mund të paraqitet rritja. Kjo vlen edhe për mirëmbajtjen e rrugëve. Kur e kam çuar unë si kërkesë, e kam paraparë që punëtorët ta kenë pagën 450 euro, me arsyetimin se pagat janë të ulëta, por ndërkohë edhe qeveria mori vendim për pagën minimale. Tash, pas gjashtëmujorit, pagat do të shkojnë në 500 euro, prandaj mund të paraqitet diferenca.

zn.Milohate Ajeti, drejtoreshë: Nuk janë paguar të gjitha obligimet. Kemi ende obligime të papërfunduara; nuk e dimë saktësisht sa janë, por mund ta nxjerrim një vlerë të përafërt.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo gjendje që e tha Jakupi do të na përcjellë edhe më tutje. E dimë që raporti financiar që ka ardhur në fund të vitit ka qenë mbi 4 milionë, që na përcjellin si borxhe dhe obligime. Tash duhet ta dimë që këto obligime do të na përcjellin edhe për dy vite, derisa të paguhen. A jeni që kjo pikë të shkojë në Kuvend, pra me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim? Kjo pikë shkon për Kuvend.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nisjen e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale (NPL) në Komunën e Vitisë

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Kemi pasur iniciativë për dhënien e stacionit të autobusëve disa herë për Gjilanin, por dy herë nuk ka kaluar në Kuvend. Gjithmonë është ngritur çështja pse Komuna e Vitisë të mos prodhojë një kompani publike. Prandaj, kryetari ka caktuar një komision lidhur me ecjen e procedurave për themelimin e kompanisë. Në propozim-vendim i keni të përcaktuara detyrat që do t'i ketë kompania dhe çfarë do të menaxhojë. Unë konsideroj që hasim në mirëkuptim ligjor dhe e bëjmë themelimin e saj. Besoj se komunës do t'i shërbejë shumë, në veçanti qytetarëve të Komunës së Vitisë. Prandaj, e keni para jush propozim-vendimin dhe besoj që edhe në Kuvend do ta miratojmë, në mënyrë që kjo çështje të ecë përpara.

z.Illir Zuka: Kur të bëhet ky komision, si formohet, a duhet me qenë pjesë edhe Kuvendi?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Jo, iniciativa del prej ekzekutivit, sepse ata kanë përgjegjësi për të, ndërsa themelimi i kompanisë, mbi bazën e statutit, cakton një bartës që do t'i japë llogari Kuvendit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo është themelim nga Kuvendi. Ndërmarrje publike komunale kanë formuar edhe Kaçaniku, Kamenica dhe Podujeva. Këto janë formuar në pesë vitet e fundit, sepse më herët ka ekzistuar aspekti ligjor që komunat nuk kanë pasur të drejtë të formojnë ndërmarrje, ndërsa tash kjo është lejuar. Kjo procedurë mund të zgjasë deri në dy vite, derisa të bëhet themelimi, sepse ka procedura të caktuara. Pra, kjo është çështje e Kuvendit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Një çështje ku kam insistuar është mirëmbajtja e varrezave. Tash, kush e paguan atë? Normalisht, komuna e paguan. Siç tha kryesuesi, këto pika janë të tilla që gjysmën e paguan komuna, por me rëndësi është që ajo, si ndërmarrje publike komunale, mund të jetë ekzistenciale, për shkak se e ka burimin e të hyrave.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshembull, në Ferizaj, pagesën që e bëjmë ne për bashkësitë fetare për shërbime të varrimit, ia paguajmë kompanisë, ndërsa kompania ua ndan hoxhallarëve në bazë të marrëveshjes që e ka.

z.Basri Aliu: Si iniciativë për formimin e kësaj ndërmarrjeje, është një iniciativë e mirë dhe mendoj që duhet ta ketë edhe komuna jonë, për shkak se, siç u përmend edhe më herët, ne disa shërbime i kryejmë përmes

kompanive private. Këtu do të ishte e udhës që të përfshihej që kjo kompani, e cila formohet, t'i kryejë këto shërbime dhe të ketë edhe punësim për qytetarët, në mënyrë që të mos përfitojnë vetëm kompanitë e tjera, sepse çdo kompani që merr punë ka edhe fitimin e vet. Në këtë mënyrë, mjetet do të mbeteshin në komunën tonë. Por ajo që më shqetëson është se për themelimin e kësaj ndërmarrjeje duhet të parashihet edhe ndarja e një buxheti të caktuar, në mënyrë që ajo të ketë disa asete dhe të jetë funksionale. Gjithashtu, në nenet 3 deri në 9 janë të përcaktuara shërbimet që mund t'i kryejë kompania. Megjithatë, vërej se edhe te shërbimet publike, pika 3.a, komuna i kryen përmes kontraktimit me operatorë ekonomikë privatë, ku përfshihet pastrimi, mirëmbajtja e hapësirave publike, mirëmbajtja e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Këtu është pak e ndërlikuar që kjo kompani t'i marrë përsipër këto shërbime, sepse një pjesë e tyre i mirëmban edhe Hidrodrini (ose operatorët përkatës të ujësjellësit), dhe në momentin që hyn kjo ndërmarrje, duhet me u sqaru mirë ndarja e kompetencave. Po ashtu, edhe te ndriçimi publik kërkohen njerëz profesionalë, të fushës, prandaj është pak e vështirë me u parapa që kjo kompani ta mirëmbajë vetë ndriçimin publik pa staf të specializuar dhe pa kornizë të qartë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Basri, ajo kompani është obligative me i gjetë njerëzit profesionalë. Por te çështja e mirëmbajtjes së kanalizimeve, ne aktualisht jemi duke e bërë përkohësisht, prandaj ndoshta mundemi me ja shtuar aty, deri sa ai lokalitet të kalojë në menaxhimin e Hidromoravës.

z.Basri Aliu: Ju mundeni me i pa edhe në komuna të tjera që i kanë themelur këto kompani, me i marrë si shembull, sidomos te mirëmbajtja e rrugëve verore ose dimërore. Unë nuk mund të them që një kompani e vetme mundet me i mirëmbajt rrugët, sepse aty hyn asfaltimi dhe punë të tjera që kërkojnë investime të mëdha në asete, të cilat kompania duhet me i pas për me i kry këto shërbime.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Mos e ka kuptimin se drejtoria e shërbimeve publike nuk qet tender, komuna ja jep kompanisë komunale, e tash tek mirëmbajtja verore p.sh. ka kjo kapacitet me i hek barishtat, po e marr shembull, po nuk ka kapacitet për asfalt. Ajo e gjen një kompani tjetër, e kontrakton, edhe në këtë formë kam mendu unë që e kanë bë.

z.Bekim Azizi Kryesuesi: Ministria ka me i kthi se çka ka kompetencë kjo kompani me bë, nuk mundemi na me shti çkado në kompani komunale, sepse janë edhe kompanitë regjionale. Mundet Ministria me thanë se përgjegjës për mirëmbajtjen e ujësjellësit është kompania regjionale, nuk ke qasje, menjëherë të bën minus.

z.Basri Aliu: Nuk po e bëj si pyetje që nuk kanë të drejtë, por po flas për gjendjen reale: a mund t'i kryejë ato, sepse një kompani të cilën e formon komuna duhet me pas asete shumë të mëdha për me i kry këto punë. Duhet me pas për shtrimin e asfaltit, për ngjeshje, etj. Ato janë investime shumë të mëdha që komuna nuk mundet me i bë. Si iniciativë është e mirë, p.sh. këto elementare munden me u bë, sepse janë investime të vogla dhe mund të kryhen, si pastrimi i objekteve komunale.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Dua të lidhem vetëm me atë që tha kryesuesi, se në letër bën me ekzistuar. Në rast se kemi seriozitet, konsideroj që mundet me qenë një prej kompanive më të forta që ka me qenë në Komunën e Vitisë. Ti po thua mjetet, por jam i bindur që këta që jemi këtu dhe të tjerët që punojnë në ekzekutiv, sa e keni shkel botën e jashtme, me pas pas një kompani të tillë të formume, veç donacionet që janë të interesume vendet europiane për pastërti dhe shërbime, besoj që bëhet bukur shumë.

Por po shkojmë edhe në anën tjetër që nuk është shumë me i nda 500 mijë me i ble disa makina.

zn.Liridona Bislimi: Nënkyetari e përmendi që kjo kompani, nëse formohet, mendohet me qenë një ndër më të fuqishmet brenda institucionit dhe unë konsideroj që prej tërë këtyre viteve që jam përfaqësuese, kjo ka qenë pika më e ndjeshme, dmth me e zgjerume që kemi marrë ndonjëherë. Unë mendoj që detyra jonë si anëtarë të KPF-së është me e analizu deri në detaje se sa është e qëndrueshme dhe e arsyeshme, për shkak se këtu fillon problemi. E kemi një pikë tepër të zgjeruar, janë diku 9 tema kryesore që diskutohen, na ka ardh komplet ky material me 2 fleta, është tepër i përgjithshëm. Pika e parë, nuk kemi analizë financiare, nuk kemi studim fizibiliteti ose ndonjë plan që kemi marrë shembull prej ndonjë institucioni tjetër që jemi mundu pak me ja

përshtat kësaj. Si u përmend, nuk e dimë se çfarë kosto ka me i kushtu komunës. Nuk mundemi me bë veç formë shabllone. Sa punëtorë kanë me u punësu, ose mbi të gjitha nuk e dim funksionin e saj, mandej se si ka me qenë pjesa e pagesës, a ka me qenë lehtësim apo dështim. Unë mendoj që duhet me qenë shumë e qartë kjo punë. Është shumë mirë nëse formohet, nuk jam kundër kësaj, por mua më duket që është vendim shumë i nxituar dhe nuk ka analizë në bazë të kësaj që pash. Ne mundemi me kalu në Kuvend, po çka më vonë, sa funksionon? Kërkesa ime specifike, që mendoj që është e arsyeshme dhe në interes të qytetarëve, është që së pari me u bë një studim i detajizum, qysh u përmend edhe për lokacionin, financat, punëtorët, për shkak se neve na vyn kostoja konkrete dhe përfitimet që kanë me qenë prej kësaj, edhe a kemi me pas mekanizma të garantum që kanë me funksionu më vonë. Në këtë formë si është sot ky propozim, mua nuk po më jep siguri që ka me funksionu. Kisha propozu që me u plotësu me këto elemente që i përmenda. Nëse keni mundësi në Kuvend me sjellë në mënyrë më të detajizume, sepse ka shumë paqartësi që ne as vetë nuk i dimë, e le më me ja shpjegu dikujt tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne veç duhet me kuptu që është nismë, veç jemi tu dhanë lejen si Kuvend me fillu procedurën.

z.Illir Zuka: Shumë gjëra që deshta me i diskutu i tha edhe Liridona. Ne e dimë që kemi kalu në lexim të parë ndryshime statutare në statut, e di që kanë me u kriju edhe dy drejtori shtesë. Njëra prej këtyre dy drejtorive që kanë me qenë është drejtorja e shërbimeve publike, e cila ka me u nda, edhe emergjenca. Çfarë funksioni po i le drejtorisë së shërbimeve publike nëse ne ja marrim pikën 4, mirëmbajtjen e hapësirave publike? Dhe tjetra, ne paguajmë ujësjellësin si Pozheran 1.70 cent, paguajmë edhe për kanalizim.

z.Jakup Demiri: Projekti kur të dorëzohet duhet ta ketë aspektin financiar, edhe e dyta për disa projekte duhet ta ketë lokacionin. Unë thashë që krejt këto diskutime që u bënë u dasht me u bë një debat publik.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mua më ka ra me u konsultu Podujevën veç për një çështje, 2-3 vite e ka blloku ministria për një kontest të vogël. Dmth këtë ne para 2 viteve nuk mundemi me kalu në ministri, se ka me na ardh në Kuvend, ka me u bë projekt, ka me të kërku çështje financiare, ka me të kërku statut, ka me të kërku rregullore dhe gjithçka që ka me funksionu. E kjo është veç ministria me na thonë po, e tani ne me ja nisë me procedura.

z.Basri Aliu: Ndoshta keq u kuptova në atë kuptimin te disa. Tash, si iniciativë është iniciativë e mirë dhe a duhet të shkojë kjo gjithsesi po. Unë e pata problemin tek disa ekzagjerime në këtë kuptim, se këto detaje tjera kur të merret leja, ti mundesh me i bë dhe duhesh me pru atë planin e fizibilitetit, vendcaktimin që e përmendi edhe nënkryetari, edhe këto që i thashë janë kompetencë e dikujt tjetër. Se nëse marrim këtë vendim, ndoshta mos po e ngarkojmë që me i kry edhe këto obligime tjera kjo ndërmarrje, se nuk i ka kapacitetet në këtë kuptim. Këtë e pata, se kjo kompani me mujtë edhe këto me i kry krejt në rregull është, por në qoftë se ne marrim një vendim që edhe këto ka me i kry, atëherë kemi telashe. Për këtë duhet me pas qartësi rreth kësaj. Edhe këto që janë punët në Drejtorinë e Shërbimeve Publike nuk është telashe, aty ka edhe punë tjera, hapësirat publike, rregullimi dhe mirëmbajtja, ato punë prap ka me i kry. Se ti po i kryen me kompani, ajo njëjtë i bjen sikur me atë kompaninë tjetër; duhesh me i thonë edhe kësaj që duhesh me e kry mirë, si shembull.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Vetë debati përcakton se sa e rëndësishme është, dhe po pajtohem i krejt që si iniciativë është e qëlluar. Një çështje duhet ta kemi të qartë, për shkak të një përvojë që kam, se kam qenë këshilltar komunal kur Komuna e ka pas marrë një iniciativë të tillë dhe e ka pas ndërpre në atë kohë. Kjo sot është dokument i kompletuar që është vetëm iniciativë. Kur ta merr lejen, se ka me të thanë ministria që je në konform ligjit për themelim të kompanisë, duhet me shku në këtë digaster, ai digasteri të thotë që duhet me pru statutin, duhet me pru rregulloren, etj. Kur ta çojsh ti statutin aty, të thotë duhet me parapri lokacionin, ku e ki, krejt të shtinë në hapa, dhe në fund ka me qenë dokumentacion i kompletuar. Përndryshe s'mun i merr, të ndalojnë në ministri. Po e them edhe prej përvojës, kur e kemi bë Parkun Industrial në Budrikë, e kryshim disa gjëra: këtë e ke kry, këtë jo, edhe shko kryje. Dhe në fund kompletohet. A na pret detyrë e rëndë, siç tha kryesuesi,

ishalla kryhet për dy vjet, por megjithatë iniciativa është e mirë dhe duhet me ecë përpara, ndërsa kompletimi i saj duhet me u bë ashtu siç kërkohet.

z.Basri Aliu: Te këto dy tjerat që i përmenda, ti i bën obligative që ky propozim-vendim me u shti në statut, dhe këtu është problemi që tash mos po e ngarkojmë vetveten me këto gjëra që me i kriju.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këto hynë në aplikim në bazë të kapacitetit që ke. Nuk ke kapacitet, nuk hynë.

z.Basri Aliu: Është mendimi im ky, nuk do të thotë që e kam unë mirë. Unë i kisha hjek disa dhe i kisha lënë vetëm disa punë të tjera që mundesh me i shti më vonë, e jo me marrë si obligim edhe mirëmbajtjen e rrugëve, sepse tani më s'mund të shpallim tender dhe e bllokojmë vetveten në këtë kuptim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk më ka mbetë për debat, a jeni që kjo pikë të shkojë në Kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër e asnjë abstenim kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e parcelës kadastrale të pronës komunale

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Është një kërkesë për ndarje, të cilën e ka sjellë kadastri së bashku me urbanizmin, dhe në shkresën që e lexova është edhe një pëlqim ekzistues i këtij pronari. Unë kam thënë që mos të shkojmë përpara, sepse në rast se nuk e kemi pëlqimin, mundet me na u kthi si e paligjshme. D.m.th kërkesa është bërë që duhet me obligu drejtorin, në kuadër të kësaj kërkesë, që drejtoria në Kuvend me sjellë pëlqimin e Drejtorisë së Kadastrit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse kjo është te Policia, që hyn ky katrori këtu, ky katrori është një rrugë te parkingu. Ky objekti po thotë me nda tokën komunale për rrugë. A është pronë komunale?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Jo, kjo tjetra është pronë komunale dhe këtë është tu ja dhënë komunës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këtu po shkruan me nda pronën komunale për me bë rrugë. Po këtu po thotë edhe me prish objektin, dhe ky po e lejon prishjen e objektit për me bë rrugë. Tash, a është objekti i këtij në pronën komunale, vendi ku është i ndërtum, apo është pronë e tij? Nëse është pronë e tij, ky mundet me shku te noteri me bë një marrëveshje që unë po e jap për rrugë komunale dhe me kërku pëlqim për prishje, atëherë shkon për rrënim, sikur që po bëhen edhe rrugët publike. Ky e bën publik dhe kurgjo nuk ndryshon. Ne nuk mundemi me nda arën e këtij me vendim. Ne nuk mundemi me i dhanë pëlqim me prish e me ndërtu, se pëlqim i jep drejtoria, Kuvendi nuk jep pëlqim për prishje e ndërtim, sepse ka planin urbanistik. Këtu po thotë "propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim-vendimit për ndarjen e parcelës kadastrale të pronës komunale". Dmth ne jemi te ndarja për me bë rrugë. Këtu nuk jemi te ndarja e një prone për me bë rrugë. Në bazë të kësaj letre dhe në bazë të kësaj, unë nuk po e shoh që përputhen këto dyja. Për mua kjo nuk është e njëjtë.

z.Illir Zuka: Për me pa të drejtën, ky e ka dhënë këtë vijë këtu. Ky ia ka dhanë banesave, dmth 63 metra katror ia ka dhënë banesave për me pas të drejtë me apliku për leje. Lexoje mirë, a? Kjo nuk është rrugë. Ky po e jep pronën e vet për me u shfrytëzu si rrugë, për shfrytëzim të banorëve. Krejt banorët me e pas qasjen, bëhet rrugë publike.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Gjeje diku ku po thotë 2582-6 me u bë rrugë dhe u kry. Këtu nuk po e thotë këtë, nuk po përputhet.

zn.Liridona Bislimi: Kryesues, kam një vërejtje si udhëheqës i këtij komiteti. Është mirë që prej organeve kompetente, në këtë rast drejtorive përkatëse, kur t'i sjellin pikat për me u vendos, me qenë të kompletuara. Sinqerisht, neve kur na ka ardh në moment kjo pikë që e kemi marrë si material, edhe pse ka ardh më kohë, ka qenë veç një fletë dhe nuk kemi pas informacione, veç 1%. Shiko tash ku janë pasojat, këtu nuk po kemi mundësi me analizu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka më për debat, a jeni që kjo pikë të shkojë në Kuvend, pra me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër e asnjë abstenim? Kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kryesuesi e prezantoi para anëtarëve të KPF-së këtë pikë të rendit të ditës dhe e hapi debatin. Pasi që nuk pati diskutim, e hodhi në votim me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër e asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për transferin (rialokimin) e mjeteve buxhetore në programin buxhetor në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kryesuesi e prezantoi para anëtarëve të KPF-së këtë pikë të rendit të ditës dhe e hapi debatin. Pasi që nuk pati për diskutim, e hodhi në votim me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër e asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi
